



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 709 Prot.

Tiranë, më datë 02.07.2020

VENDIM

Nr. 194, datë 09.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Proedurave Administrative, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e vazhdimit të procedurës së legalizimeve për objektin “Godinë banimi 1 kate + 1 nëntokë”, Durrës, me aplikues Z. Avdyl Tahir Lacku, për shkak të vendndodhjes me potencial arkeologjik të shprehur në relacionin përshkrues bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRËTAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elda MARGARITI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KESHILLI KOMBETAR I TRASHEGIMISE KULTURORE MATERIALE


RELACION SHPJEGUES

Territori i Kodër Vilës në Durrës (Zona B) dhe potenciali arkeologjik



VENDGJETJE ME POTENCIAL TË LARTË

- Nr. 1 – Banesë romake: gërmuar dhe botuar.
- Nr. 2 – Varrezë mesjetare: gërmuar
- Nr. 3 – Pjesë fortifikimi (?): gërmuar
- Nr. 4 – Kisha paleokristiane e Sh.Gjergjit (?)
- Nr. 5 – Dikur kullë fortifikimi, sot Vila e ish mbretit Zog.
- Nr. 6 – Varre shek. IV-V: gërmuar, botuar
- Nr. 7 – Tempull arkaik i orderit dorik (?)
- Nr. 8 – Varre paleokristiane me afresk: gërmuar, botuar.
- Nr. 9 – Hapësire religjioze me monument me naiskos, rrugë procesionesh, varre romake antike të vona: gërmuar dhe botuar.
- Nr. 10 – Komplekse varresh shek. VI-XI: gërmuar.
- Nr. 11 – Mozaik romak: gërmuar.
- Nr. 12 – Rrugë romake: vëzhgim arkeologjik.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KESHILLI KOMBETAR I TRASHEGIMISE KULTURORE MATERIALE

- Territori i varrezës njihet falë shumë gjetjeve të shpërndara në zonë, por nuk njihen kufijtë e saktë të shtirjes së hapësirës funerare.
 - Zotërojmë të dhëna për gjurmë strukturash, jo varre : të paktën në 3 raste (tempull, monument me naiskos, kishë).
 - Elementet e sistemit fortifikues lokalizohen në të gjithë territorin sipas një linje pak a shumë të qartë, përveç traktit me vija të ndërprera.
 - Lugina midis kodrës së Stanit dhe kodrës së Dautës ka dhënë elementë të mjaftueshëm rreth pranisë së një lagjeje romake, por për shkak të pozicionin ku ndodhet, nuk është gjurmuar mjaftueshëm.
 - Mungesa e të dhënave në pjesën tjetër të territorit, nuk është për shkak të mungesës së gjurmëve arkeologjike, por vjen si rezultat i pamundësisë për të marrë informacion nga terreni. Thellësitë e gjetjeve paraqesin tre tipare.
- Në gjurmimet e vendosura në kreshtën e kodrës, thellësia varion nga 0,50 deri në 1m (p.sh. varret në vengjetjen nr. 2 dhe 4).
- Kur vendgjermimi është në shpatet e kodrës, në të gjitha rastet nga krahu i kreshtës së kodrës thellësite janë të konsiderueshme, deri 3-4 m; ndërsa në krahun e kundërt me kreshtën, thellësia është më e vogël, madje shpeshherë strukturat janë shumë pranë/thuajse në sipërfaqe (p.sh. varret në piken nr. 6 janë në sipërfaqe dhe të vizitueshme ende sot).
- Në fundin e kodrave thellësia varion, si rezultat i aktivitetit modern në terren. Ka raste kur gjenden menjëherë pranë sipërfaqes (p.sh. Lagja e poçareve) ose nga 2m deri në 4 m thellësi (p.sh. varreza e shek. IV-I p.Kr.).

BIBLIOGRAFI

1. C. ABADIE-REYNAL, E. SHEHI, *Projekti Shqiptaro-Francez "Topografia e Epidamne-Dyrrachium"* Durrës 2015, Arkivi i Institutit të Arkeologjisë.
2. S. ANAMALI, "Nekropoli Helenistik i Epidamnit", *Buletin për Shkencat Shoqërore 1*, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë 1957, f. 30-63.
3. S. ANAMALI, DH. BUDINA, "Gjermime në nekropolin e Durrësit (materiale të vitit 1957)", *Buletin i Universitetit të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore 2*, 1960, f. 222-233.
4. A. ANASTASI, *Gjermime emergjence në Durrës, Fushata e vitit 2007*. Arkivi i fondeve arkeologjike Durrës.
5. M. GAGLIONE, E. SHEHI, "Un documento angioino del 1280 per il 'castrum Durachii'", *Archivio Storico per le Province Napolitane CXXXVII*, 2019, f. 353-370.
6. A. DHIMA, "Materiale skeletore nga nekropoli i Dyrrahut", *Iliria* 15, 1983, f. 247-272.
7. A. GUTTERIDGE, A. HOTI, (P. Reynolds coll.), "The walled town of Dyrrachium, Durrës. New light on the early defenses", *Journal of Roman Archaeology* 16, f. 367-379.
8. A. HOTI, "Dy varre të periudhës së antikitetit të vonë në Durrës", *Iliria* 1, 1984, f. 223-225.
9. L. HEUZEY, A. DAUMET, *Mission archéologique de Macédoine*, vol. 2, texte et planches, Paris 1876.
10. GJ. KARAKSIKAJ, A. BAÇE, "Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë", *Monumentet* 9, 1975, f. 5-26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KESHILLI KOMBETAR I TRASHEGIMISE KULTURORE MATERIALE

11. C. PRASCHNIKER, A. SCHÖBER, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien 1919.
12. L. REY, Les remparts de Durazzo, *Albania I*, 1925, f. 33-48.
13. E. SHEHI, Contributo sulla topografia di Dyrrachium, *Journal of Ancient Topography XVII*, 2007, f. 159-208
14. E. SHEHI, B. SHKODRA-RRUGIA, "Le front nord des fortifications de Dyrrhachium. Données nouvelles et hypothèses", në J.- L. Lamboley, M. P. Castiglioni (eds.), *L'Illyrie Méridionale et l'Épire dans l'antiquité, V. Actes du V^e colloque international de Grenoble* (8-11 Octobre 2008), Paris 2011, f. 325-336.
15. B. SHKODRA-RRUGIA, "Hapësirat funerale dhe qyteti në Dyrrachium gjatë periudhës romake të vonë deri në mesjetën e hershme", *Iliria* 41 (2017), f. 289-334.
16. F. TARTARI, "Një varrezë e mesjetës së hershme në Durrës", *Iliria* 14-1 (1984), f. 227-250.
17. F. TARTARI, "Një grup varresh të shek. II-IV të erës sonë në zonën kodrinore të nekropolit të Dyrrahut", *Iliria* 17-1 (1987), f. 153-166.
18. F. TARTARI, *Raport mbi kontrollin e kryer në faqen jugore të kuotës 98 m (Akropoli) 1991*, Arkivi i Institutit të Arkeologjisë
19. F. TARTARI, *Varreza e shekujve I-IV të erës sonë në Dyrrah*, Durrës 2004.
20. F. TARTARI, *Përmbledhje artikujsh*, Durrës 2008.
21. V. Toçi, "Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Dyrrahut në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike", *Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë 15-21 nëndor 1962. Tiranë 1965, f. 460-46
22. Raportet e gërmimeve të paraqitura në KKA nga individë/shoqëri të licencuara
23. Informacione të pabotuara nga arkeologë të Durrësit.

